Funded by the European Union

Transformimi i institucioneve publike për ofrimin e shërbimeve sociale në komunitet



Duration: 15.09.2025 - 15.09.2027

Countries:
North Macedonia

EU contribution: € 511 000

Total budget: € 511 000

Implementer:
NTU International A/S Consortium

Project description:

Ky projekt synon të mbështesë avancimin e reformës kombëtare të sistemit të mbrojtjes sociale të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, përmes Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve (MPSDR). Fokusi i projektit është promovimi i deinstitucionalizimit, duke kaluar nga një sistem institucionesh të mëdha rezidenciale në një sistem shërbimesh sociale gjithëpërfshirëse të bazuara në komunitet për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Për më tepër, projekti synon të forcojë kapacitetin e administratës publike për të menaxhuar dhe zbatuar investimet e Bashkimit Evropian në sektorin social. Projekti do të ofrojë asistencë teknike për transformimin dhe rehabilitimin e tre institucioneve kryesore publike: “Banja Bansko” në Strumicë, Institutin Special “Demir Kapija” dhe “25 Maj” - Shkup në qendra moderne të ofrimit të shërbimeve komunitare, të cilat do të ofrojnë një gamë shërbimesh gjithëpërfshirëse të përshtatura për nevojat lokale. Së fundmi, projekti do të përgatisë bazën e plotë teknike dhe administrative për punimet e rehabilitimit të planifikuara në kuadër të Programit Operacional Shumëvjeçar për Kapitalin Njerëzor (2024–2027) të financuar nga BE-ja në Maqedoninë e Veriut, dhe do të hedhë themelet për iniciativat e ardhshme të investimeve në kuadër të IPA III.

Expected results:

Projekti do të zbatohet në pesë faza kryesore, me fokus në përmirësimin dhe transformimin e tre institucioneve publike të mbrojtjes sociale: “Banja Bansko” në Strumicë, Institutin Special “Demir Kapija” dhe “25 Maj” - Shkup në qendra moderne për ofrimin e shërbimeve komunitare.
Faza 1 – Vlerësimi i nevojave
Ekspertët do të zhvillojnë një analizë të detajuar për të identifikuar nevojat e secilit prej institucioneve, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe zgjerimin e gamës së shërbimeve që ofrojnë.
Faza 2 – Projektimi i së ardhmes
Do të përgatiten projekt-zgjidhje që do të nxjerrin në pah se si do të rinovohet secili prej institucioneve dhe të përshtatet për shërbimet e reja sociale.
Faza 3 – Përgatitja për ndërtim
Do të përgatiten projekte teknike të detajuara dhe do të merren lejet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të ndërtimit në të tre lokacionet.
Faza 4 – Nisja e punimeve
Do të përgatitet dokumentacioni i tenderit për të zgjedhur kontraktorët për rehabilitimin dhe transformimin e institucioneve.
Faza 5 – Sigurimi i qëndrueshmërisë
Do të zhvillohet plan afatgjatë për të garantuar që shërbimet e reja sociale të funksionojnë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme brenda komunitetit.